

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Universiteti i Prizrenit "UKSHIN HOTI"	
Prillogje me	30.12.2019
Zyra e pranimat	Nr. i pranimat
308	01-489



**UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN**  
**UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN**

Ruga e Shkronjave Nr. 1, 20000

Prizren, Republika e Kosovës;

Tel: +381 (0) 29- 232 140;

Homepage: [www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

**RREGULLORE E PUNËS SË SENATIT TË**  
**UNIVERSITETIT**

Prizren, Dhjetor 2019



Në bazë të dispozitave ligjore të nenit 46 dhe të nenit 48 pika 1.24, e Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” (tutje referuar si Universiteti). Senati i këtij Universiteti në mbledhjen e mbajtur më: 27.12.2019 miratoi:

## **Rregulloren e punës së Senatit të Universitetit**

### **I. Dispozitat e përgjithshme**

#### **Neni 1**

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës së Senatit të Universitetit “Ukshin Hoti” (konvokimi, kryesimi dhe mbarëvajtja e mbledhjeve), vendimmarrja, procedura e zgjedhjes, zbatimi i vendimeve dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e Senatit, Komisioneve të tij dhe trupave të tjerë punues.

Çështjet që kanë të bëjnë me mënyrën e punës së Senatit dhe që nuk janë të rregulluara me Ligj, me Statut dhe me këtë Rregullore, mund të rregullohen me vendim të veçantë të Senatit.

Senati dhe komisionet e tij, si dhe trupat e tjerë punues të tij, i ushtrojnë kompetencat nga fushëveprimi i tyre në mbledhjet e rregullta, të jashtëzakonshme dhe zgjedhore.

Senati mund të organizoj mbledhje solemne me rastin e jubileve, festave dhe rasteve të tjera të rëndësishme, si edhe mbledhjeve komemorative me rastin e vdekjes së ndonjë anëtari të dalluar të Universitetit. Vendimin për organizim të mbledhjeve solemne dhe komemorative e merr Rektori.

### **II. Përbërja e Senatit dhe verifikimi i mandatit të anëtarëve të Senatit**

#### **Neni 2**

Anëtarët e Senatit me të drejtë vote janë:

1. Rektori;
2. Prorektorët;
3. Dekanët e të gjitha njësive akademike si vijon:

3.1.Fakulteti i Ekonomisë

3.2.Fakulteti i Filologjisë

3.3.Fakulteti Juridik

3.4.Fakulteti i Edukimit

3.5.Fakulteti i Shkencave Kompjuterike



### 3.6. Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit

- 1.4. Nga një anëtar i zgjedhur nga stafi akademik i secilës njësi akademike sipas njësive akademike të përshkruara në pikën 3 të nenit 2 të kësaj rregulloreje.
  - 1.5. Dy anëtarë të zgjedhur nga parlamenti i studentëve nga radhët e studentëve të Universitetit. Studentët anëtarë të Senatit duhet të jenë student të dalluar me notë mesatare së paku tetë (8), dhe nuk duhet të jenë përsëritës të vitit akademik.
  - 1.6. Një anëtar të zgjedhur nga stafi joakademik.
  - 1.7. Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit është anëtar i përhershëm i Senatit, pa të drejtë vote.
4. Për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të Senatit, në përputhje me dispozitat e Statutit Senati i UUHP-së, nxjerr rregullore të veçantë.
5. Mbledhjen konstituive të Senatit e thërret Rektori në detyrë i Universitetit, i cili e kryeson atë vetëm derisa të zgjedhet kryesuesi i përkohshëm i Senatit.

### Neni 3

- (1) Në mbledhjen e parë, Senati i verifikon mandatet e anëtarëve të Senatit në bazë të raportit të prezantuar nga Sekretari i Përgjithshëm në lidhje me rregullsinë e zgjedhjeve të anëtarëve të Senatit nga njësite akademike, me propozim për verifikimin e mandatit.
- (2) Votimi për raportin bëhet në tërësi, nëse nuk është kontestuar asnjë mandat. Në rast se ndonjë mandat është kontestuar, së pari votohet për të gjitha mandatet e pakontestueshme, e pastaj për çdo mandat të kontestueshëm votohet ndarazi.
- (3) Nëse Senati konstaton se zgjedhja e ndonjë anëtari është bërë në mënyrë jo të rregullt, Senati do të kërkoj nga njësia akademike përkatëse që ta përsëris zgjedhjen e kontestuar.
- (4) Anëtari i Senatit, të cilit i është kontestuar ose i është shtyrë vendimi për verifikimin e mandatit, ka të drejtë të vazhdoj pjesëmarrjen në mbledhje, por pa të drejtë vote.

### Neni 4

Pas verifikimit të mandatit, anëtarët e Senatit e nënshkruajnë deklaratën etike si vijon:

“Deklaroj se do t’i kryej detyrat me nderë dhe me besnikëri, me drejtësi dhe paanueshmëri, me ndërgjegje dhe përgjegjësi, se do t’i përfaqësoj denjësisht dhe me përkushtim interesat e Universitetit dhe se do t’i përmbahem Statutit të Universitetit”.

## III. Zgjedhja e Kryesuesit të Përkohshëm të Senatit

### Neni 5



- (1) Kryesuesi i përkohshëm i Senatit zgjedhet nga kandidatët e propozuar në Senat me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
- (2) Nëse asnjë nga kandidatet e propozuar nuk e merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, atëherë organizohet radha e dytë e votimit vetëm për kandidatin me numër më të madh të votave. Nëse kandidati nuk e merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve në radhën e dytë, konsiderohet se kandidati është refuzuar dhe Senati është i obliguar të propozoj kandidatë të tjerë.
- (3) Në rast të votave të barabarta, votimi përsëritet.

#### **IV. Mbledhjet**

##### **Neni 6**

- (1) Rektori i cakton procedurat për mbledhjet e Senatit dhe të komisioneve të tij.
- (2) Mbledhjet e Senatit i thërret dhe i kryeson Rektori i Universitetit, sipas funksionit (në tekstin e mëtejshëm: kryesuesi).
- (3) Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e përgatit dhe e kryeson njëri prej prorektorëve sipas radhës së paraparë nga Rektori. Nëse edhe prorektorët nuk kanë mundësi të marrin pjesë në mbledhje, mbledhjen e Senatit e kryeson anëtari më i vjetër i Senatit i pranishëm në mbledhje.
- (4) Kryesuesi i thërret mbledhjet e Senatit sipas nevojës. Gjatë periudhës së rregullt të studimeve, mbledhjet e Senatit mbahen së paku një herë në muaj, kurse ditën e mbajtjes së mbledhjeve e cakton kryesuesi.
- (5) Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të mbahen në çfarëdo kohë sipas procedurave të parapara. Rendi i ditës për këto mbledhje është i kufizuar në një pikë kryesore.
- (6) Në mbledhjen e Senatit mund të vendoset për thirrjen e ndonjë mbledhjeje të ardhshme të Senatit. Në këto raste anëtarët e Senatit që nuk janë të pranishëm, ftohen posaçërisht.
- (7) Në rast të shkarkimit të Rektorit dhe prorektorëve, kryesimin e Senatit e merr anëtari më i vjetër i Senatit pa asnjë vonesë.
- (8) Mbledhjet e Senatit janë të hapura për publikun, në veçanti kur Senati vendos të jetë e mbyllur, me vendim të veçantë dhe të arsyetuar.
- (9) Ftesat për mbledhje të Senatit dërgohen së paku tri ditë para mbledhjes. Në raste të jashtëzakonshme, kur kërkohen veprime urgjente, ftesat mund të dërgohen në afat edhe më të shkurtë së tri ditë. Ftesat mund të bëhen me shkrim, me e\_mail, ose në çfarëdo formë tjetër teknike, me të cilën ftesa dhe informimi janë të sigurt.



- (10) Kryesuesi ka të drejtë në çfarëdo kohe të ftoj ekspertë, ose të ftoj persona të tjerë në mbledhje, pa të drejtë vote.
- (11) Kryesuesi është i obliguar të thërrasë mbledhjen e Senatit nëse këtë e kërkojnë së paku 1/3 e anëtarëve të Senatit dhe nëse ajo është e arsyetuar me shkrim. Nëse kryesuesi i Senatit nuk i përgjigjet kërkesës brenda tri ditësh nga dita e marrjes së kërkesës, mbledhjen e Senatit e thërret anëtari më i vjetër i Senatit.

## **V. Pjesëmarrja në mbledhje dhe përfaqësimi**

### **Neni 7**

- (1) Të gjithë anëtarët e Senatit kanë të drejtë dhe janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Senatit.
- (2) Gjatë mbledhjeve të Senatit, anëtarët duhet të votojnë personalisht. Delegimi i votës nuk lejohet.
- (3) Para se të filloj mbledhja e Senatit anëtarët nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes e cila është pjesë integrale e procesverbalit. Anëtari i Senatit mund të mungoj nga mbledhja për shkaqe të arsyeshme, por për mosardhje në mbledhje anëtari i Senatit e njofton më kohë kryesuesin.

### **VI. Neni 8**

- (1) Konsiderohet se një anëtar i Senatit ka konflikt interesi në të gjitha situatat që parashihen me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe nëse ka interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, personal, ekonomik ose pasuror rreth çështjeve që shqyrtohen në Senat, i cili ndikon, mund të ndikoj ose duket sikur ndikon në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të detyrës.
- (2) Anëtari i Senatit që ka konflikt interesi e ka për detyrë ta njoftoj Kryesuesin se ka konflikt interesi me çështjen që shqyrtohet dhe vendoset në Senat. Nëse anëtari i Senatit nuk e bënë një gjë të tillë, përfundimi se i njëjti ka konflikt interesi mund të nxirret edhe nga informata të tjera të besueshme e me ç'rast kërkohet deklarimi i anëtarit të Senatit rreth konfliktit të mundshëm të interesit.
- (3) Anëtari që ka konflikt interesi nuk ka të drejtë vote për çështjen përkatëse dhe si rregull, duhet të lëshoj mbledhjen gjatë diskutimit dhe vendosjes së çështjes për të cilën ka konflikt interesi.



## **VII. Fillimi i mbledhjes dhe miratimi i rendit të ditës**

### **Neni 9**

- (1) Kryesuesi e hap, e kryeson, e ndërpret dhe e përfundon mbledhjen e Senatit.
- (2) Për përgatitjen e materialeve për mbledhje kujdeset kryesuesi në koordinim me Prorektorët dhe sekretarin e përgjithshëm.
- (3) Kryesuesi është i obliguar t'i përfshij në rend të ditës propozimet e arsyetuara me shkrim të dërguara 72 (shtatëdhjetë e dy) orë para mbledhjes. Propozimet me shkrim duhet të jenë të nënshkruara nga parashtruesi dhe mund të dorëzohen personalisht, ose të dërgohen me postë, ose me e-mail.
- (4) Në fillim të mbledhjes, Kryesuesi konstaton nëse janë të pranishëm shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Senatit. Kuorumi është i nevojshëm për fillimin e seancës, miratimin e rendit të ditës, miratimin e procesverbalit dhe për vendimmarrjen e Senatit (përveç në rastet kur kërkohen,  $(2/3)$  dy të tretat e votave të anëtarëve të Senatit).
- (5) Mospjesëmarrja pa arsye në tri mbledhje radhazi, automatikisht nënkupton heqje dorë nga mandati i anëtarit të senatit. Në këtë rast në mbledhje të radhës do të ftohet anëtari i personelit akademik i njësisë akademike përkatëse i cili ka marrë më së shumti vota për anëtarë të Senatit pas kandidatit i cili tërhiqet pra, zëvendësimi duhet të jetë në përputhje me dispozitat ligjore të Rregullores për zgjedhjen e anëtarëve të Senatit të Universitetit.
- (6) Kryesuesi e propozon rendin e ditës, e hap diskutimin rreth rendit të ditës dhe e vendos në votim atë. Anëtarët e Senatit kanë të drejtë të propozojnë ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës, duke e arsyetuar propozimin dhe urgjencën e propozimit të tillë. Rendi i ditës miratohet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm që votojnë.

## **VIII. Ecuria e mbledhjes**

### **Neni 10**

- (1) Pas miratimit të rendit të ditës, kalohet në miratimin e procesverbalit të mbledhjes paraprake.
- (2) Anëtarët e Senatit kanë të drejtë që të paraqesin vërejtje në procesverbal dhe të kërkojnë që të bëhen ndryshime, ose plotësime. Për themelësinë e vërejtjeve në procesverbal vendoset me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm që votojnë.



- (3) Raportin dhe arsyetimin për secilën pikë të rendit të ditës e paraqet kryesuesi ose personi i caktuar nga kryesuesi, pas të cilit kryesuesi e hap diskutimin,
- (4) Të gjithë anëtarët e pranishëm të Senatit mund të marrin pjesë në diskutim dhe t'i paraqesin mendimet dhe propozimet lidhur me çështjet që do të vendosen në mbledhje.
- (5) Kryesuesi ua jep fjalën anëtarëve të Senatit sipas radhës së paraqitjes për diskutim. Në mbledhjet e Senatit askush nuk mund të diskutoj pa e marr fjalën nga kryesuesi i mbledhjes.
- (6) Kryesuesi është përgjegjës për respektimin e Rregullores së punës, dhe për mbarëvajtjen e mbledhjes.
- (7) Për çdo pikë të rendit të ditës pjesëmarrësit mund të diskutojnë më së shumti dy herë.
- (8) Kryesuesi ka të drejtë të kërkoj nga folësit që t'i përmbahen temës.
- (9) Pjesëmarrësi i cili e merr fjalën është i obliguar t'i përmbahet çështjes që është në shqyrtim. Çdo pjesëmarrës që konsideron se lidhur me fjalën e tij është shtrembëruar ndonjë fakt, me lejen e kryesuesit ka të drejtë të paraqitet për replikë menjëherë pasi të përfundoj diskutimin pjesëmarrësi ndaj të cilit është paraqitur replika. Replika për të njëjtën çështje i lejohet pjesëmarrësit në diskutim vetëm dy herë dhe sipas rregullit, mund të zgjasë më së shumti dy minuta.
- (10) Kryesuesi ka të drejtë të caktoj pushim gjatë mbledhjes më së shumti 30 (tridhjetë) minuta, dhe me pajtimin e Senatit, pushimi mund të zgjatet.
- (11) Nëse pas fillimit të mbledhjes shkaktohet mungesa e kuorumit, kryesuesi i senatit duhet ta ndërpresë mbledhjen.
- (12) Kryesuesi mund të ndërpres mbledhjen në rastet si në vijim:  
Nëse mbledhja e Senatit nuk mund të përfundoj të njëjtën ditë;  
Nëse prishet rendi në mbledhje dhe kryesuesi nuk mund të vendosë rendin me mjete të rregullta.

#### **Neni 11**

Senati në bazë të propozimit të kryesuesit ose të ndonjë anëtari të Senatit mund të vendos që shqyrtimi i disa çështjeve specifike të ndërpritet dhe të bëhen përgatitje me të hollësishme për mbledhjen e ardhshme.

### **IX. Vendosja - votimi dhe zgjedhjet**

#### **Neni 12**



- (1) Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve, sipas pikës së rendit të ditës, Senati merr vendim ose konkluzion. Vendimet dhe konkluzionet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të Senatit, nëse me Statut ose me këtë Rregullore nuk është përcaktuar ndryshe.
- (2) Votimi në mbledhje të Senatit bëhet me aklamacion (me ngritje të dorës) ose me votim të fshehtë. Për mënyrën e votimit, Senati vendos në mbledhjen përkatëse.
- (3) Vendimet, Senati i merr me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, përveç në rastet e përcaktuara ndryshe me statut dhe me këtë rregullore.
- (4) Para se të votohet, kryesuesi i njofton anëtarët e Senatit se shumica është e nevojshme për marrjen e vendimit.
- (5) Nëse ka më shumë propozime të vendimeve ose të konkluzioneve, së pari votohet për ato të përfshira në material ose në propozimet e Kryesuesit, pastaj për propozimet e tjera.
- (6) Kryesuesi e shpall rezultatin e votimit dhe i njofton të pranishmit në mbledhje nëse është miratuar, ose jo propozimi i hedhur në votim.
- (7) Para se të votohet, kryesuesi e formulon propozimin e vendimit ose të kërkesës lidhur me çështjen që vendoset.
- (8) Anëtari i Senatit voton duke u deklaruar “për”, “kundër” ose “abstenon”.

### **Neni 13**

- (1) Procedurën e votimit të fshehtë e zbaton Komisioni për votim, i përbërë nga tre anëtarë të Senatit me të drejtë votë, të zgjedhur nga Senati. Komisioni për votim, nga radhët e veta e zgjedh kryetarin e komisionit.
- (2) Pas votimit, në bazë të rezultateve të votimit, kryesuesi, përkatësisht kryetari i komisionit, konstaton se propozimi i vendimit ose i konkluzionit është miratuar ose është refuzuar.

### **Neni 14**

Votimi me vota të fshehta bëhet për:

Zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues,

Zgjedhjen e kryesuesit të përkohshëm të Senatit,

Zgjedhjen e komisionit profesional për propozimin e listës së kandidatëve për Rektor,

Për shkarkimin e Dekanit,

Për shkarkimin e prodekanit,

Çështjet për të cilat kryesuesi kërkon votim të fshehtë.





- (2) Votimi me vota të fshehta bëhet me fletëvotime.
- (3) Mbikëqyrja e votimit duhet bërë nga një komision i veçantë, ad - hoc, i përberë vetëm nga anëtarët e Senatit me të drejtë vote.
- (4) Senati, me shumicë votash e përcakton tekstin e propozimit që votohet fshehtë.
- (5) Komisioni për votim e vërteton fletëvotimin duke e vulosur me vulë të Universitetit.
- (6) Para se të vazhdoj me votim, Kryesuesi i njofton anëtarët se cila është shumica e nevojshme për të vendosur. Në rastet kur paraqitet, ose propozohet numër më i madh kandidatësh se sa numri që do të zgjedhet, para se të filloj votimi, Kryesuesi i propozon Senatit metodologjinë e reduktimit të listës së kandidatëve dhe numrin e raundeve të votimit.
- (7) Sekretari i përgjithshëm i thërret anëtarët e Senatit një nga një dhe ju dorëzon fletëvotimet dhe për këtë mban evidencë të veçantë.
- (8) Për rezultatet e votimit të fshehtë, Komisioni përgatitë raport. Komisionit i siguron ndihmë teknike sekretari i përgjithshëm. Raporti përmban të dhëna për numrin e: fletëvotimeve të dorëzuara; fletëvotimeve të gjetura në kutinë e votimit; fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme; votave për ose kundër, ose për candidate individual, si dhe deklaratën nëse propozimi është miratuar, respektivisht kandidati që është zgjedhur, ose kandidatet e kualifikuar për raundin tjetër të votimit. Fletëvotime të pavlefshme konsiderohen: fletëvotimi i zbrazët; fletëvotimi nga i cili nuk mund të përcaktohet me siguri se si ka votuar anëtari; fletëvotimi në të cilin janë rrumbullakuar më shumë kandidatë sesa numri që zgjedhet. Raporti nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe ai është pjesë integrale e procesverbalit të mbledhjes së Senatit.

#### **X. Zgjedhja, përbërja dhe detyrat e Komisionit profesional për propozimin e listës së kandidatëve për Rektor**

##### **Neni 15**

- (1) Secili anëtar i Senatit ka të drejtë të propozohet kandidat për anëtar të Komisionit profesional për propozimin e listës së kandidatëve për Rektor. Komisioni përbëhet prej: katër anëtarë profesorë dhe një anëtari student.
- (2) Propozimin e kandidateve për anëtar të Komisionit profesional e bëjnë anëtarët e Senatit.
- (3) Komisioni profesional në përbërjen e tij do të këtë pesë anëtarë.
- (4) Komisioni profesional prej pesë anëtarësh për propozimin e listës së kandidatëve për Rektor zgjedhet me vota të fshehta sipas procedurës së paraparë me këtë Rregullore.



- 
- (5) Komisioni profesional ka për detyrë që të verifikoj nëse kandidatët e paraqitur për pozitën e rektorit i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs.

## **XI. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues nga Personeli Akademik i Universitetit**

### **Neni 16**

- (1) Senati shpall zgjedhjet për anëtarë të Këshillit Drejtues nga radhët e personelit akademik të Universitetit.
- (2) Zgjedhjet për Këshillin Drejtues mbahen në qershor, kurse mandati i Këshillit Drejtues fillon më, 1 tetor.
- (3) Senati përcakton kalendarin e procedurës zgjedhore dhe formon komisionin zgjedhor prej tre anëtarësh për të menaxhuar procesin e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Drejtues.
- (4) Vendimi i Senatit për shpalljen e zgjedhjeve nga alineja 1 e këtij neni publikohet në ueb-faqen e Universitetit, shpërndahet përmes e-mailit zyrtar dhe postohet në tabelat e shpalljeve në të gjitha njësitë akademike të Universitetit.
- (5) Procedura e përshkruar në nenet 17-24 të kësaj Rregulloreje zbatohet edhe në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të një ose më shumë anëtarëve të Këshillit.

Drejtues ose nëse në Këshillin Drejtues kanë mbetur vende të paplotësuara. Në raste të tilla Senati shpall zgjedhjet për vendet e paplotësuara në Këshillin Drejtues më së shumti 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas përfundimit të parakohshëm të mandatit të një ose më shumë anëtarëve të Këshillit Drejtues ose pasi ka mësuar se vendi ka mbetur i paplotësuar për çfarëdo arsye.

### **Neni 17**

- (1) Secili anëtar i personelit akademik me titull të profesorit në Universitet, dhe që është në marrëdhënie të përhershme pune ka të drejtë të kandidohet për anëtar të Këshillit Drejtues të Universitetit.



- (2) Përgjithimisht nga alineja 1 e këtij neni nuk mund të zgjidhen për anëtar të Këshillit Drejtues: Rektori, prorektorët, dekanët, prodekanët, anëtarët e senatit, sekretari i përgjithshëm dhe sekretaret e njësive akademike të Universitetit.
- (3) Kandidimi bëhet brenda afatit të përcaktuar nga Senati, duke dorëzuar një letër motivimi dhe CV-në.

#### **Neni 18**

- (1) Me të përfunduar të procedurës së kandidimit, komisioni zgjedhor shqyrton dokumentacionin e kandidateve të paraqitur.
- (2) Komisioni zgjedhor përcakton nëse kandidatet e paraqitur i plotësojnë kushtet nga neni 18 i kësaj Rregulloreje, si dhe nëse dokumentacioni i aplikimit është i kompletuar.
- (3) Lidhur me këtë komisioni i paraqet raport Senatit, me propozim të listës së kandidatëve që i plotësojnë kushtet për kandidim.
- (4) Raporti i komisionit zgjedhor bashkë me dokumentacionin e kandidateve i dërgohet anëtarëve të Senatit të paktën një javë para mbajtjes së mbledhjes zgjedhore.

#### **Neni 19**

- (1) Në fillim të mbledhjes zgjedhore, Senati shqyrton raportin e komisionit zgjedhor dhe përcakton listën përfundimtare të kandidatëve që i plotësojnë kushtet nga neni 18 i kësaj Rregulloreje.
- (2) Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues bëhet me vota të fshehta.
- (3) Komisioni zgjedhor, me ndihmën e Administratës së Universitetit, përgatit fletëvotimet me emrat e kandidatëve të radhitura sipas alfabetit.
- (4) Komisioni Zgjedhor siguron kushte për votim të fshehtë dhe numërim transparent të votave.
- (5) Votimi për anëtarë të Këshillit Drejtues zhvillohet në më së shumti tri cikle votimi. Për secilin cikël votimi, në rast të ndarjes së barabartë të votave, mund të organizohen deri në dy cikle të jashtëzakonshme votimi.
- (6) Pas çdo cikli bëhet numërimi i votave dhe komunikohen rezultatet, si dhe eventualisht, përcaktohet lista e kandidatëve për ciklin vijues.

#### **Neni 20**

- (1) Në ciklin e parë, secili anëtar i Senatit duhet të rumbullakësoj deri në katër kandidatë në fletëvotim. Fletëvotimet me më shumë se 4 (katër), kandidatë të rumbullakësuar konsiderohen të pavlefshme.



- (2) Konsiderohen të zgjedhur ata kandidatë që kanë fituar shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Senatit.
- (3) Nëse numri i kandidateve që kanë fituar shumicën e numrit të përgjithshëm të votave është më i madh se pesë, atëherë konsiderohen të zgjedhur kandidatët që kanë fituar më së shumti vota.

### **Neni 21**

- (1) Nëse në ciklin e parë të votimit nuk janë zgjedhur katër anëtarë të Këshillit Drejtues organizohet cikli i dytë i votimit.
- (2) Në ciklin e dytë kualifikohen kandidatët që kanë fituar më së shumti vota në ciklin e parë, por jo edhe shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Senatit. Numri i kandidatëve të tillë mund të jetë më së shumti sa trefishi i vendeve të paplotësuara në Këshillin Drejtues. Nëse në mesin e tyre ka kandidatë me numër të barabartë të votave, lista i përfshin të gjithë kandidatët.
- (3) Nëse numri i kandidatëve të mbetur është më i vogël se trefishi i vendeve të paplotësuara, atëherë në ciklin e dytë përfshihen të gjithë kandidatët.
- (4) Në ciklin e dytë secili anëtar i Senatit duhet të rumbullakësoj me së shumti aq kandidatë sa janë vende të paplotësuara në Këshillin Drejtues. Fletëvotimet me më shumë kandidatë të rumbullakësuar sesa numri i vendeve të paplotësuara në Këshillin Drejtues konsiderohen të pavlefshme.
- (5) Konsiderohen të zgjedhur ata kandidatë që kanë fituar shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Senatit.
- (6) Nëse numri i kandidatëve që kanë fituar shumicën e numrit të përgjithshëm të votave është më i madh se numri i vendeve të paplotësuara, atëherë konsiderohen të zgjedhur kandidatët që kanë fituar më së shumti vota.

### **Neni 22**

- (1) Nëse në ciklin e parë dhe të dytë të votimit nuk janë zgjedhur katër anëtarë të Këshillit Drejtues organizohet cikli i tretë i votimit.
- (2) Në ciklin e tretë kualifikohen kandidatët që kanë fituar më së shumti vota në ciklin e dytë, por jo edhe shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Senatit. Numri i kandidatëve të tillë mund të jetë më së shumti sa dyfishi i vendeve të paplotësuara në Këshillin Drejtues. Nëse në mesin e tyre ka kandidatë me numër të barabartë të votave, lista i përfshin të gjithë kandidatët.



- (3) Nëse numri i kandidatëve të mbetur është më i vogël se dyfishi i vendeve të paplotësuara, atëherë në ciklin e dytë përfshihen të gjithë kandidatët.
- (4) Në ciklin e tretë secili anëtar i Senatit duhet të rrumbullakësoj më së shumti aq kandidatë sa janë vende të paplotësuara në Këshillin Drejtues. Fletëvotimet me më shumë kandidatë të rrumbullakësuar sesa numri i vendeve të paplotësuara në Këshillin Drejtues konsiderohen të pavlefshme.
- (5) Konsiderohen të zgjedhur ata kandidatë që kanë fituar më së shumti vota.

### **Neni 23**

- (1) Nëse në njërin nga tri ciklet e votimit, në mesin e kandidatëve që i kanë plotësuar kushtet për t'u zgjedhur anëtarë të Këshillit Drejtues, ka kandidatë me numër të barabartë të votave, ndërkohë që numri i vendeve të paplotësuara është më i vogël sesa numri i përgjithshëm i kandidatëve që i kanë plotësuar kushtet për t'u zgjedhur anëtarë të Këshillit Drejtues, atëherë organizohet cikli i jashtëzakonshëm i votimit.
- (2) Në ciklin e jashtëzakonshëm të votimit kualifikohen kandidatet me numër të barabartë të votave në kuptimin e alinesë 1 të këtij neni.
- (3) Në ciklin e jashtëzakonshëm të votimit secili anëtar i Senatit duhet të rrumbullakësoje me së shumti aq kandidatë sa janë vende të paplotësuara në Këshillin Drejtues. Fletëvotimet me më shumë kandidatë të rrumbullakësuar sesa numri i vendeve të paplotësuara në Këshillin Drejtues konsiderohen të pavlefshme.
- (4) Konsiderohen të zgjedhur ata kandidatë që kanë fituar më së shumti vota.
- (5) Në rast të pamundësisë së zgjedhjes për shkak të ndarjes së barabartë të votave, cikli i jashtëzakonshëm i votimit përsëritet.
- (6) Nëse edhe cikli i dytë i jashtëzakonshëm nuk nxjerr kandidatët fitues, procedura për plotësimin e vendeve të paplotësuara përsëritet në përputhje me këtë Rregullore.

## **XII. Votimi për miratimin e zgjedhjes së Dekanit dhe delegatit të përkohshëm në senat.**

### **Neni 24**

- (1) Dekani zgjedhet me dy të tretat (2/3), e votave të anëtarëve të Senatit me propozimin e këshillit të fakultetit për një periudhë katër (4) vjeçare. Dekani zgjedhet nga radha e profesorëve të fakultetit përkatës, për një periudhë katërvjeçare, më të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat dhe i propozohet Senatit për miratim.
- (2) Mandati i rregullt i Dekanit i miratuar nga Senati fillon me një (1) tetor.



- (3) Për zgjedhjen e Dekanit të ri, Këshilli i Njesisë Akadematike e zgjedh një delegat nga profesorët e fakultetit, i cili përkohësisht e mban mandatin e Dekanit në Senat, derisa të përfundoj procedura e zgjedhjes së Dekanit të ri. Pastaj, Dekani i ri e merr mandatin ashtu siç parashihet me këtë Rregullore dhe Statut të Universitetit.
- (4) Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të Dekanit siç përcaktohet në nenin 70 pika 1 të Statutit, Dekani i porsazgjedhur do të zgjedhet sipas procedurës së njëjtë për periudhën e mbetur të mandatit.

### **XIII. Votimi për zgjedhjen e Prodekanëve të njësive akademike**

#### **Neni 25**

- (1) Dekani i zgjedhur ia propozon Këshillit të Njesisë Akadematike, Prodekanët e mundshëm për mandatin e përbashkët, të cilët zgjedhën në këshill dhe i përcillen Senatit për miratim.
- (2) Prodekanët zgjedhen me dy të tretat (2/3) e votave të anëtarëve të Senatit me propozimin e Këshillit të Fakultetit për një periudhë katër (4) vjeçare, nga radha e profesorëve të fakultetit përkatës, më të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat.
- (3) Kandidatët për postin e Prodekanit duhet të jenë individë me kualifikime relevante akademike dhe të kenë aftësi dhe përvojë në udhëheqje, si dhe të kenë së paku thirrjen e profesorit siç parashihet në Statut.
- (4) Mandati i rregullt i Prodekanëve fillon me një (1) tetor.
- (5) Në rast të përfundimit të mandatit të Dekanit, përfundon edhe mandati i prodekanëve.
- (6) Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të Prodekanit siç përcaktohet në nenin 71 pika 1 të statutit, Dekani e propozon kandidatin e ri në detyrën e Prodekanit, i cili zgjedhet në procedurë të njëjtë për periudhën e mbetur të mandatit të Prodekanit të shkarkuar.

### **XIV. Mbajtja e rendit me mbledhje**

#### **Neni 26**



- (1) Për mbajtjen e rendit në mbledhje kujdeset kryesuesi i mbledhjes.
- (2) Për shkeljen e rendit në mbledhje, kryesuesi dhe Senati mund të shqiptoj masat në vijim:  
Vërejtje gojazi,  
Marrja e fjalës dhe  
Largimi nga mbledhja.

#### **Neni 27**

- (1) Vërejtje gojazi mund t'i shqiptohet të pranishmit nëse me sjelljen dhe me diskutimin e tij çrregullon dhe pengon punën normale të mbledhjes.
- (2) Marrja e fjalës i shqiptohet anëtarit të Senatit, që me sjelljet dhe me deklaratat e tij çrregullon punën normale të Senatit për të cilën më parë i është shqiptuar vërejtje.
- (3) Largimi nga mbledhja i shqiptohet pjesëmarrësit nëse edhe pasi t'i merret fjala pengon mirëvajtjen e mbledhjes.
- (1) Largimin nga mbledhja e shqipton Senati me shumicë votash. Pjesëmarrësit të cilit i është shqiptuar kjo masë, është i detyruar që menjëherë të largohet nga mbledhja. Largimi nga mbledhja bëhet vetëm për atë mbledhje.

### **XV. Procesverbali nga mbledhja e Senatit**

#### **Neni 28**

- (1) Në çdo mbledhje të Senatit mbahet procesverbal. Procesverbalin e nënshkruajnë kryesuesi dhe procesmbajtësi.
- (2) Përveç mbajtjes së procesverbalit, mbledhjet e Senatit duhet të inçizohen në versionin audio.
- (3) Procesverbali duhet të përmbaj këto elemente:  
vendin, datën dhe kohën e fillimit dhe të mbarimit të mbledhjes, rendin e ditës, listën e pjesëmarrësve dhe të atyreve që mungojnë, të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse, shënimet thelbësore mbi rrjedhën e mbledhjes.  
Dokumentet shtesë duhet t'i bashkangjiten procesverbalit.
- (4) Procesverbali duhet të përgatitet brenda një jave pas mbledhjes së Senatit, dhe si ekstrakt duhet t'u dërgohet anëtarëve të Senatit me rastin e dërgimit të materialit për mbledhjen e ardhshme të Senatit.



- 
- (5) Procesverbali miratohet në mbledhjen e radhës të Senatit.
  - (6) Audio-incizimi dhe procesverbali me materialet e shqyrtuara sipas pikave të rendit të ditës ruhen në arkiv të Universitetit, si dokumente afatgjate.

## **XVI. Formimi i komisioneve të Senatit dhe funksionimi i tyre**

### **Neni 29**

- (1) Komisionet janë organe ndihmëse të Senatit.
- (2) Komisionet e formuara nga Senati në pajtim me Statutin e Universitetit i ndihmojnë Senatit, për çështje të veçanta të punës së tij.
- (3) Komisionet e përhershme të Senatit janë si në vijim:
  - 3.1. Komisioni i Studimeve;
  - 3.2. Komisioni i Ankesave;
  - 3.3. Komisioni Disiplinor;
  - 3.4. Këshilli Botues;
  - 3.5. Këshilli i Cilësisë.
  - 3.6. Këshilli Shkencor dhe
  - 3.7. Këshilli i Etikes
- (4) Komisionet e përkohshme të Senatit janë si në vijim:
  - 4.1. Komisioni për Hartimin e Rregulloreve;
  - 4.2. Komisionet Ad-hoc për Çështje të Veçanta;
  - 4.3. Komisionet Këshillëdhënëse Ad-hoc për Çështje të Veçanta.
- (5) Formimi i Komisionit të Studimeve rregullohet sipas dispozitave të Statutit të Universitetit.
- (6) Përbërja e komisionit të ankesa është si në vijim:
  - 6.1. Tre mësime të ndryshme.
  - 6.2. Pjesë e Komisionit të Ankesave duhet të jetë përfaqësuesi i Parlamentit të Studentëve në cilësinë e vëzhguesit pa të drejtë vote.
  - 6.3. Lidhur me funksionimin e komisionit të ankesave gjegjësisht puna e tij rregullohet me rregullore të veçantë të miratuar nga Senati.
- (7) Komisioni Disiplinor formohet nga Senati i Universitetit, në përputhje me rregulloren për procedurën disiplinore të miratuar nga Këshilli Drejtues i Universitetit.





- 
- (8) Komisionit për Hartimin e Rregulloreve të Senatit duhet të përbëhet nga tre apo pesë anëtarë.
  - (9) Komisionet për Hartimin e Rregulloreve duhet të formohen me përbërje gjithëpërfshirëse.
  - (10) Mandati i komisioneve të renditura në pikë 3 (Ttre), të këtij neni zgjatë sa vetë mandati i Senatit. Ndërsa, mandati i komisioneve tjera është ad-hoc për çështje të caktuara.
  - (11) Për funksionimin, kompetencat, mandatin dhe mbarëvajtjen e punës së komisioneve të lartcekura Senati i Universitetit, nxjerr Rregullore të veçantë.
  - (12) Gjatë zgjedhjes së komisioneve preferohet të merret parasysh përfaqësimi gjinor.

## **XVII. Aktet e Senatit dhe hyrja në fuqi e tyre**

### **Neni 30**

- (1) Senati nxjerr:
  - Rregullore,
  - Vendime,
  - Konkluzione,
  - Rekomandime.
- (2) Senati jep interpretim autentik të akteve që i miraton.
- (3) Procesmbajtësi është i obliguar t'i përgatitë vendimet, konkluzionet dhe rekomandimet nga mbledhja e Senatit, ndërsa rregulloret i përgatitë komisioni përkatës.

### **Neni 31**

Vendimet e Senatit hyn në fuqi në momentin e miratimit të tyre.

### **Neni 32**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje vlejné për të gjithë anëtarët e Senatit dhe për persona të tjerë të ftuar ose të angazhuar në procedurat e Senatit.

### **Neni 33**

Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore zbatohen dispozitat e Statutit dhe të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës.

## **XVIII. Dispozitat përfundimtare**

### **Neni 34**



- (1) Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje bëhet sipas procedurës së njëjtë me atë të miratimit të saj.
- (2) Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje në ditën e miratimit nga Senati i Universitetit, shfuqizohen Rregulloret, vendimet apo udhëzimet e tjera të mëparshme të kësaj natyreje.
- (3) Rregullorja hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati i Universitetit.

**Kryesues i Senatit të Universitetit**

**Prof. Asoc. Dr. Ismet TEMAJ**

